

**SHOQËRIA AKSIONARE
SCAN SH.A.**

Regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS K12312001A
Me seli regjistruar në adresën: Rruga Aleksandër Moisiu, Ish-Kinostudio, godina e Kinofilmit, Tiranë

**VENDIM
I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË**

Sot më 19.12.2022 (dymijë e njëzet e dy) në orën 10.00, në selinë e shoqërisë Scan SH.A. me NUIS K12312001A (më tej referuar si 'Shoqëria'), u mbajt Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me të pranishëm:

BALFIN – BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SH.P.K., një shoqëri e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, e regjistruar me NUIS K72223031K dhe seli të regjistruar në adresën Rruga Papa Gjon Pali II, Kati 11, ABA Business Center, Tiranë, Shqipëri, me ortak të vetëm, Z. Samir MANE, dhe e përfaqësuar ligjërisht nga Znj. Edlira Muka në cilësinë e administratorit të shoqërisë ('Aksionari').

Znj. Edlira Muka, e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton Znj. Eva Veizaj të kryejë funksionin e sekretarit të mbledhjes.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dyte të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

REND DITE

- I. Rritja e kapitalit themeltar të Shoqërisë me një vlerë prej 33,871,900 Lekë (tridhjetë e tre milion e tetëqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind lekë) ;***
- II. Të ndryshme;***

Në përputhje me parashikimet e Statutit, Shoqëria ka një kapital themeltar në shumën 294,860,583 Lekë. Për arsye operationale të Shoqërisë, Ortaku i Vetëm dëshiron të kontribuojë në rritjen kapitalit themeltar të Shoqërisë me vlerën 33,871,900 Lekë. Asambleja pasi e shqyrtoi dhe vlerësoi me kujdes pikat e rendit të ditës si më lart,

VENDOSI


- I. Të miratojë rritjen e kapitalit të Shoqërisë me kontribut në para në vlerën 33,871,900 Lekë (tridhjetë e tre milion e tetëqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind lekë). Pas rritjes, kapitali i regjistruar i Shoqërisë do të bëhet 328,732,483 Lekë (treqind e njëzet e tetë milion e shtatëqind***

e tridhjetë e dy mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë), i përbërë nga 3,287,325 aksione me vlerë nominale 100 Lekë secili.

- II. Autorizohet Administratori, Znj. Vanova Strakosha që, duke vepruar personalisht ose duke autorizuar persona te tjerë të bëjë të mundur regjistrimin e këtij vendimi ne regjistrin tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit dhe në çdo institucion tjetër ku regjistrimi apo njoftimi është i kërkuar me ligj.

Meqenëse nuk ka çështje të tjera për diskutim, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme deklarohet e mbyllur në orën 11:00.

KRYETARI


Edlira Muka

SEKRETARI


Eva Veizaj

